

**Njoftim për përqendrim me të cilin ALFI RE, shoqëri për administrimin e fondeve alternative të investimeve, d.o.o., Slloveni, do të fitojë kontroll mbi pasuri në pronësi të shoqërive DSV Contract Logistics d.d., Slloveni, DSV Road d.o.o., Slloveni dhe DSV Road Austria AG, Austri
(Lënda nr. 08-107/2026)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më 07.07.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin ALFI RE, shoqëri për administrimin e fondeve alternative të investimeve, d.o.o., me seli të regjistruar në Rr. Verovškova 55A, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, do të fitojë kontroll të vetëm mbi pasuri në pronësi të shoqërive DSV Contract Logistics d.d., me seli të regjistruar në Rr. Brnčičeva 51, 1231 Lubjanë – Črnuče, Republika e Sllovenisë, DSV Road d.o.o., me seli të regjistruar në Struževo 90, Kranj, Republika e Sllovenisë, dhe DSV Road Austria AG, me seli të regjistruar në Gottfried-Schenker-Straße 1, Vjenë, Republika e Austrisë, nëpërmjet shitblerjes së pasurisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

ALFI RE, shoqëri për administrimin e fondeve alternative të investimeve, d.o.o. (në tekstin e mëtejshëm: „ALFI RE“) është shoqëri për administrimin e fondeve alternative të investimeve dhe është e regjistruar në Agjencinë e Tregut të Letrave me Vlerë të Sllovenisë. ALFI RE është e regjistruar në emër dhe për llogari të fondit ALFI RE, SIS. ALFI RE është pjesë e Grupit ALFI.

Grupi ALFI është aktiv kryesisht në administrimin e investimeve dhe pasurive të paluajtshme, veçanërisht në fushën e tregtisë me pakicë, arkëtimit të borxheve dhe investimeve të tjera alternative. Grupi ALFI kryen analizën e investimeve (ekzistuese dhe potenciale) dhe administron fondet e investimeve, ndërsa administrimi i vetë investimeve pjesërisht u është besuar shoqërive të tjera brenda grupit.

Në përbërjen e tij më të gjerë, Grupi ALFI ka shoqërinë të varura të mëposhtme të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- APOLLO MK SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. „Pero Nakov“ nr. 124, Shkup – Gazi Babë, e cila është aktive në tregtinë me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesoreve për fëmijë dhe produkteve tekstile për fëmijë.

Megjithatë, Grupi ALFI aktualisht nuk ka investime dhe as veprimtari afariste në fushën e administrimit të pasurive të paluajtshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Pasuria që është objekt i transaksionit të propozuar është në pronësi të shoqërive të mëposhtme:

- (i) DSV Contract Logistics d.d., me seli të regjistruar në Rr. Brnčičeva 51, 1231 Lubjanë – Črnuče, Republika e Sllovenisë;
- (ii) DSV Road d.o.o., me seli të regjistruar në Struževo 90, Kranj, Republika e Sllovenisë; dhe
- (iii) DSV Road Austria AG, me seli të regjistruar në Gottfried-Schenker-Straße 1, Vjenë, Republika e Austrisë.

Pasuria objekt i transaksionit përfshin dy kategori të pasurive të paluajtshme, të cilat aktualisht janë në pronësi dhe përdoren nga shoqëritë e sipërpërmendura, drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes shoqërive të tyre të varura:

(i) pasuri të paluajtshme për shitje; dhe

(ii) Pasuri të paluajtshme për shitje me rikthim në qira.

Prona e synuar përbëhet ekskluzivisht nga pasuri të paluajtshme të vendosura në Kroaci dhe Slloveni dhe të cilat përdoren kryesisht për qëllime magazinimi dhe si hapësirë për zyra.

Prona e synuar nuk përfshin pasuritë e paluajtshme të vendosura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për nevojat e vlerësimit të këtij përqendrimi, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës të përkufizohet si tregu i administrimit të hapësirave për zyra dhe tregu i administrimit të objekteve industriale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

15.07.2026

Shkup